



Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), në nenin 20 paragrafi 1, të ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 5, pika (d) të ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, nenit 6, si dhe udhëzimin administrativ, nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, miratoi këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KOMISIONEVE PËR REKRUTIM TË DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE DHE AFTËSUESE NË KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I.

Miratohet Vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

II.

Anëtarë të komisioneve përzgjedhëse, të cekur në pikën I të këtij vendimi, janë:

I. Komisioni përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë për nivelin e arsimit parashkollor (IP):

1. Fitnete Tutuli, zyrtare nga DKA, kryesuese;
2. Egzon Gashi / Jehona Gjurgjeala, ekspert i pavarur i arsimit, anëtar;
3. Përfaqësues nga MASHTI.

II. Komisioni përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (SHFMU):

1. Fitnete Tutuli, zyrtare nga DKA, kryesuese;
2. Egzon Gashi / Jehona Gjurgjeala, eksperte e pavarur e arsimit, anëtare;
3. Përfaqësues nga MASHTI.

III. Komisioni përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtorë për nivelin e mesëm të lartë-gjimnaze (SHML):

1. Fitnete Tutuli, zyrtare nga DKA, kryesuese;
2. Egzon Gashi / Jehona Gjurgjeala, ekspert i pavarur i arsimit, anëtar;
3. Përfaqësues nga MASHTI.

IV. Komisioni përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtorë të shkollave profesionale/IAAP-ve (SHML):

1. Fitnete Tutuli, zyrtare nga DKA, kryesuese;
2. Egzon Gashi / Jehona Gjurgjeala, ekspert i pavarur i arsimit, anëtar;
3. Përfaqësues nga MASHTI.

III.

Anëtarët e komisioneve, të cekur në pikën II të vendimit, të zgjedhur nga Drejtoria e Arsimit (DKA), në bazë të nenit 6, paragrafi 9 i Udhëzimit administrativ (MASHT), nr. 151/2020, të datës 22.12.2020, përcaktohen në komisione për rekrutimin e drejtorëve dhe zv.drejtorëve që përzgjedhen për një (1) vit shkollor, 2023/2024.

IV.

Detyrë e komisionit është zbatimi i dispozitave të Udhëzimit administrativ (MASHT), nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Arsimit.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-204106/23, më 10.10.2023

